



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.101-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ZL.Anr.101-4/2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it ZL.Anr.101/2025 të datës 06.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 10.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar kërkesa për rishikim ZL.Anr.101-4/2025 e datës 08.10.2025, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit të PZAP-it, ZL.Anr.101/2025 të datës 06.10.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 800.00 euro (tetëqind euro), dhe e ka detyruar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.

Arsyetim

Paneli me vendimin ZL.Anr.101/2025, të datës 06.10.2025, e kishte miratuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, dhe i ka shqiptuar dënim më gjobë në lartësi prej 800.00 euro (tetëqind euro), duke e detyruar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit, si dhe ka urdhëruar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë që nga momenti i marrjes së vendimit të largoj-heq posterin e vendosur në rrugën "Mbretëresha Teutë" në Vushtrri.

PZAP-i, me datë 08.10.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtim e vendimit ZL.Anr.101-4/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendohet se poster i vendosur me material promovues nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore që rregullojnë fushatën dhe vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësirat publike, në Vushtrri nga kandidatja për asamble komunale znj. Dorentina Gela. Tutje kanë shtuar se vendosja e posterit nuk është bërë në hapësirë publike, por në pronë private. Këtë fakt nuk e konteston as vetë vendimi i PZAP-it, i cili megjithatë argumenton se kandidatja Dorentina Gela nuk ka marrë pëlqimin e biznesit ku është vendosur posterit. Bazuar në këto, kanë kërkuar nga PZAP që të rishikoj vendimin ZL.Anr.101/2025, të

datës 06.10.2025 dhe që ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të refuzohet si e pabazuar.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit ZL.Anr.101/2025, të datës 06.10.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesës për rishqyrtim e datës 08.10.2025, për shqyrtimin e vendimit ZL.Anr.101/2025, të datës 06.06.2025, rezulton se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se, PZAP-i, nuk ka konstatuar se, kandidatja Dorentina Gela ka vendosur posterin në pronë private. Me vendimin me të cilin është kërkuar rishqyrtimi PZAP-i ka vlerësuar se, posteri është vendosur në rrugën “Mbretëresha Teutë”, në Vushtrri duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së saj, e që është në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në vendimin për të cilin është kërkuar rishqyrtimi i tij Paneli vetëm ka dhënë arsye se ka vlerësuar edhe përgjigjen në ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, duke theksuar se, e njëjta nuk ka pasur ndikim për vendosje ndryshe nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të atij vendimi.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në kërkesë nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lartë.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartëcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.101-2/2025, datë 10.10.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.